



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

Nr. 3846 / 1 Prot. Datë 9.7.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 12515 / 1 Prot. Datë 26.7.2021

UDHËZIM

Nr. 13, datë 9.7.2021

PËR

**ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E SESIONIT TË DYTË TË PROVIMEVE TË
MATURËS SHTETËRORE 2021 DHE MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2021**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës "a", të pikës 2 të nenit 26 dhe nenit 51 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",

U D H Ë Z O J:

1. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2021, sesioni i dytë, të jenë:

- | | |
|-----------------------------|-----------------|
| a) Gjuhë e huaj | 24 gusht 2021 |
| b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi | 27 gusht 2021 |
| c) Matematikë | 31 gusht 2021 |
| ç) Provimi me zgjedhje | 03 shtator 2021 |

2. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë, të jenë:

- | | |
|-----------------------------------|-----------------|
| a) Gjuhë e huaj | 24 gusht 2021 |
| b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi | 27 gusht 2021 |
| c) Matematikë | 31 gusht 2021 |
| ç) Teori profesionale e integruar | 03 shtator 2021 |

3. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2021 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni dytë, bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore, miratuar me urdhrin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
4. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2021 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë:
 - a) Fillojnë në orën 10:00.
 - b) Provimet e detyruara dhe me zgjedhje zgjasin 2 orë e 30 minuta.
 - c) Testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).
5. Në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2021 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë, do të marrin pjesë:
 - a) Maurantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore 2021 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i parë.
 - b) Maurantët që rezultojnë mbetës në një ose dy lëndë në vitin shkollor 2020-2021 dhe i shlyejnë provimet shkollore brenda datës 17 gusht 2021.
 - c) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2020, por që nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021.
 - ç) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, që kanë të njësuar dokumentet shkollore nga QSHA dhe kanë detyrime të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021.
6. Kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja “c” dhe “ç”, të këtij udhëzimi të regjistrohen në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm ose në shkollën që u cakton Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar/Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (këtu e në vijim DRAP/ZVAP) në vendbanimet e tyre.
7. Maurantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja “b”, “c” dhe “ç”, të këtij udhëzimi, të plotësojnë Formularin A1Z, për dhënien e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, nëse nuk e kanë plotësuar atë në sesionin e parë. Këta kandidatë të plotësojnë Formularin A1Z, në datat 18-20 gusht 2021.
8. Drejtori i institucionit arsimor parauniversitar të dërgojë zyrtarisht në ZVAP, listën e kandidatëve që do të marrin pjesë në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2021 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë, deri më datë 18 gusht 2021. Drejtori i ZVAP, ta dërgojë këtë listë në QSHA, në datën 18 gusht 2021.
9. Provimet të zhvillohen të përqendruara në ZVAP. ZVAP-et, të përcaktojnë qendrat dhe mjediset ku maurantët/kandidatët do të zhvillojnë provimin, duke mundësuar përqendrimin e tyre sipas kushteve dhe numrit të maurantëve/kandidatëve.
10. ZVAP-et dhe drejtoritë e institucioneve arsimore parauniversitare, të marrin masa për njoftimin e maurantëve/kandidatëve për datat, qendrën dhe orën kur do të zhvillohet secili nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2021 dhe provimet e

detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë.

11. Drejtori i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, brenda datës 16 gusht 2021, të njoftojë zyrtarisht QSHA-në dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, për qendrat dhe mjediset ku do të zhvillohen provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2021, sesioni i dytë, dhe për listën e shkollave që marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2021 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë. Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar njofton për këto qendra dhe mjedise Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR).
12. Monitorimi dhe administrimi i procesit të Maturës Shtetërore 2021 dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MASR-së dhe të institucioneve të varësisë.
13. Shpenzimet e përfaqësuesve të MASR-së në monitorimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2021 dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë, të përballohen nga institucionet përkatëse, sipas dispozitave në fuqi.
14. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtorja e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore arsimore dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTËR

Evis KUSHI



MINISTËR

Anila DENAJ

